

## 11.4 PËRCAKTIMI PARAPARAK I VLERAVE

Regjistrimin e ruajtur në skedarin e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht mund ta përzgjidhni si burim të vlerave të definuara paraprakisht, të cilat mund t'i përdorni më pas në çdo maskë për futjen e të dhënave.

### *Procedura*

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**.

Hapet dritarja **Regjistrimet e ruajtura përkohësisht**, në pjesën e sipërme të së cilës është lista e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht (shih fotografinë 11.3-1).

2. Përzgjidhni regjistrimin përkatës në listë dhe klikoni butonin **Paracakto**.

Te "Lloji" shënon *default*, ndërsa te "Emri" *vlera e paracaktuar*.

Me metodën **Redaktimi / Shto vlerën e përcaktuar** në regjistrim transferohen vlerat e përcaktuara nga regjistrimi i ruajtur përkohësisht.

Vlera e përcaktuar është e vlefshme derisa regjistrimi të fshihet nga datoteka e regjistrimeve të ruajtura përkohësisht (shih kap. 11.6).



Shënim:

*Nëse ndonjë regjistrim është caktuar si burim i vlerave të përcaktuara, butoni **Paracakto** bëhet joaktiv.*